



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01.Nr.110-288305 dt. 31.12.2014, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr. 350/02-37848/19 dt. 19.02.2019, të pronarit Arsim Rexhepi nga Prishtina, rr. “Gjon Serreqi” nr. 47, në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste me karakter të përkohshëm-automekanik në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 19.03.2019, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE PËR NDËRTESE TË PËRKOHSHME

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarit Arsim Rexhepi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-37848/19 dt. 19.02.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste me karakter të përkohshëm-automekanik, në kuadër të bllokut urban “A6” të Planit Rregullues të Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025 në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 3218-0 dhe 3219-0 ZK Prishtinë.

II. Lokacioni i parcelave kadastrale të lartcekura, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.350/05-0118238/17 dt. 22.05.2017, dhe Vendim për përmirësimin e gabimit teknik në pjesën tekstuale të Planit Rregullues të Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025, 01 nr.350/05-70156/18 dt. 23.03.2018, në zonë të planifikuar me destinim “banim i lartë i përzier”, ndërsa kushtet ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë të përkohshme-automekanik, caktohen bazuar në kriteret e “Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik”, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.110-288305 dt. 31.12.2014.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
- nr. 3218-0, me sipërfaqe $S=181 \text{ m}^2$, me pronar Arsim Rexhepi, dhe me kualitet të tokës “tokë ndërtimore”;
- nr. 3218-0, me sipërfaqe $S=267 \text{ m}^2$, me pronar Arsim Rexhepi, dhe me kualitet të tokës “tokë ndërtimore”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 3218-0 dhe 3219-0 ZK Prishtinë, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi të vogël, nga drejtimi lindje kah perëndimi, me disnivel $\sim 4.00 \text{ m}'$;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale është përmes rrugës ekzistuese publike “Hakif Sheholli”;
- Në kuadër të perimetrit prej $50 \text{ m}'$ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale të banimit.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste me karakter të përkohshëm-

Faqe 1 prej 5

ESKATË PËRCJELLUR
ME POST 105. 27. 03. 2019



automekanik në Prishtinë, bazuar në kushtet e përcaktuara në “Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik” 01 Nr.110-288305 dt. 31.12.2014, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “zgjdhja urbane”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, të jetë për afarizëm-automekanik (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar i ndërtesës të jetë P+0 dhe me lartësi maksimale 7.10 m` (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, është max. 40 %;
- Sipërfaqja e ndërtesës së planifikuar, sipas projekt propozimit, është me sipërfaqe të përgjithshme $S=179.20 \text{ m}^2$;
- Distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelës fqinje, mund të jetë deri në 120cm, me pëlqim të pronarëve të parcelave fqinje, kurse nëse në parcelat fqinje ndodhen ndërtesa ekonomike, distanca mund të eliminohet me pëlqimin e pronarëve, ndërsa sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025, distanca minimale nga kufiri i parcelës është $0.5 \times H$, ku H është lartësia maksimale e ndërtesës;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga rruga / niveli i terrenit, të jetë max.0.30 m`;
- Qasja në parcelë të jetë nga rruga e ekzistuese publike “Hakif Sheholli”, e paraqitur në Planin e situacionit - “zgjdhja urbane” të parcelës;
- Për ndërtesat (hapësirat) afariste, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për çdo 40m^2 të neto sipërfaqes së afarizmit (hapësirës afariste);
- Ndërtesa me karakter të përkohshëm lejohet të ndërtohet nga materialet montuese dhe lehtë demontuese, si: hekuri, druri, plastika, metali apo edhe ndonjë material i ngjashëm, dhe nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni (projekt propozimi është nga konstruksioni i hekurit);
- Bazamenti– themelet e ndërtesës mund të jenë nga betoni i armuar;
- Në ndërtesë nuk lejohet ndërtimi i etazheve nëntokësore;
- Në paraqitjen e situacionit të parcelës kadastrale, të paraqiten edhe organizimi i vendparkimeve të jashtme, rrugëve përreth parcelës, gjelbërimit të planifikuar, etj.;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficientës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar;
- Zgjdhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet kujdes i veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore.

V. Me dokumentacionin ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore, duhet të prezantohet:

- Deklarata e noterizuar nga pronari i parcelës, se ndërtesa është me karakter të përkohshëm, nuk do të jetë pengesë për realizimin/zbatimin e planit urban për atë zonë, dhe se do të largojë të njëjtën në afat prej 8 (tetë) ditësh.

VI. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;

- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m², me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdheshë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;

VIII. Leja Mjedisore Komunale – bazuar në nenin 9, pika 1 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale, përkatësisht shtojcës së këtij udhëzimi, aktiviteti i propozuar sipas projektit konceptual-automekanik/autoservis, i nënshtrohet procedurës për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, i hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:



- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

X. Pagesa e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesi Arsim Rexhepi nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 350/02-37848/19 dt. 19.02.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste me karakter të përkohshëm- automekanik, në lokacionin e përkohshëm në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, aplikuesi ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 3218-0 dhe 3219-0 ZK Prishtinë, evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-03218-0 dhe P-71914059-03219-0 ZK Prishtinë (kopje e vërtetuar nga origjinali, LRP. Nr. Rendor. 582/2019 dt. 29.01.2019);
- Projektin konceptual-“zgjdhja urbane”, hartuar nga kompania “Building” shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70921669;
- Manualin e incizimit gjeodezik, punuar nga kompania gjeodete e licencuar “Geo Horizont” shpk nga Prishtina, me numër të licencës 54;
- Shkresën “Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025, me referencë 04-350/01-97015/18 dt. 24.04.2018, të datës 25.04.2018, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Arsim Rexhepi, nr. 22264 dt. 30.01.2019, lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Aktin noterial “Pëlqim”, dhënë nga Selim Lecaj për Arsim Rexhepi, për pajtim të ndërsjellë për lejin e ndërtimit deri në kufi të parcelës, redaktuar dhe noterizuar te noteri Isak Ademi në Prishtinë, LRP.Nr.14374/18 dt. 20.07.2018 (kopje e vërtetuar nga origjinali, LRP.Nr.2787/19 dt. 19.02.2019);
- Aktin noterial “Autorizim për përfaqësim”, dhënë nga Arsim Rexhepi për Lumni Dervisholli dhe Fadil Dervisholli, për përfaqësim, përpiluar dhe noterizuar te noterja Merita Kostanica në Prishtinë, Nr. Rendor i LRP 580/2019 dt. 29.01.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali, LRP.NR. Rendor 583/2019 dt. 29.01.2019);
- Fotokopjen e letërnjoftimit të pronarit dhe të autorizuarit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-37848/19 dt. 19.02.2019, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, identifikimit të gjendjes faktike të lokacionit në terren, konsultimit të “Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik” 01.nr.110-288305

dt.31.12.2014, rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative dhe projektit konceptual, ka konstatuar se:

- Parcela kadastrale nr. 3218-0 dhe 3219-0 ZK Prishtinë, shtrihen pranë rrugës “Hakif Sheholli”, përkatësisht në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Kodra e Trimave 1” 2017-2025, 01 nr.350/05-70156/18 dt. 23.03.2018, dhe me destinim “banim i lartë i përzier”;

- Kërkesa e aplikuesit është që, deri në hartimin e planit rregullues për atë zonë, ti lejohet që në pronën e tij të zhvillojë ndërtimin e ndërtesës së përkohshme, dhe e njëjta të trajtohet sipas “Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik”, miratuar me Vendimin e Kuvendin Komunal të Prishtinës, 01.nr.110-288305 dt. 31.12.2014;

- Projekti konceptual, gjegjësisht kushtet ndërtimore të propozuara nga aplikuesi, janë në harmoni me kriteret e rregullores së lartcekur, andaj kjo drejtori, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, ka vendosur njoftimin me datë 01.03.2019, për të njoftuar publikun me synimin e pronarit, për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t’ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 05.03.2019, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit, dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, pas përmirësimit të vërejtjeve të konstatuara, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit në rrugën ekzistuese, si dhe organizimin e vendparkimeve, në kuadër të atij kompleksi, dhe është konstatuar, si në vijim:

“Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Arsim Rexhepi, lagja Kodra e Trimave 1, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-37848/19, të dt. 19.02.2019, zgjidhja e propozuar përfshihet në mes dy rrugëve, njëra është rruga kryesore e cila është segmenti i Unazës Qendër (rruga ekzistuese Sami Plakolli), dhe tjetra rrugë dytësore (rruga ekzistuese Bedri Gjini). Kyçja e propozuar është bërë në rrugën kryesore dhe në udhëkryqin i cili aktualisht është i rregulluar me semafora, dmth në zonë të udhëkryqit, andaj kjo zgjidhje si e tillë nuk mund të pranohet. Me qenëse zgjidhja e propozuar kufizohet edhe nga rruga dytësore Bedri Gjini, rekomandoj që kyçja të aplikohet nga kjo rrugë. Gjithashtu vendparkimet e propozuara duhet të aplikohen brenda hapësirës së zgjidhjes përmes kyçjes, jo direkt me qasje nga rruga per secilin vendparkim”.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L- 110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se aplikuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret “Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik”, 01.nr.110-288305 dt. 31.12.2014, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane".

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Aplikuesit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 350/02 – 37848/19 DT. 19.03.2019

Zyrtari,
Nazife Krasniqi

U.d. e udhëheqëses së sektorit,
Lindita Beqiri

Faqe 5 prej 5



